

D E K R E T
Nr.989, datë 20.12.1994

**PËR MARRJEN E MASAVE PËR TË PËRBALLUAR GJENDJEN E RËNDË
ENERGJETIKE NË VEND**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

D E K R E T O J:

Neni 1

Të krijohet shtabi qendror i kryesuar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave në përbërje të të cilit të jenë anëtarë të Qeverisë, Prokurori i Përgjithshëm, Kryetari i Shërbimit Informativ Kombëtar, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë si dhe Drejtori Ekzekutiv i Korporatës Energjetike Shqiptare, për përballimin e gjendjes së rëndë energjetike.

Neni 2

Këshilli i Ministrave të mobilizojë fondet e papërdorura në buxhet të vitit 1994 dhe fonde të tjera të cilat janë të nevojshme për të mbuluar importimin e nevojave energjetike për përballimin e situatës së rëndë energjetike të vendit.

Neni 3

Të gjitha furrat e bukës, që do të caktohen nga organet e pushtetit lokal, të sigurojnë vazhdimësinë e prodhimit duke u pajisur me gjenerator të cilat t’u shiten me kredi me kushte të favorshme. Në të kundërt dënohen me gjobë ose heqje të lirisë deri në 1 vit.

Neni 4

Të organizohet shërbimi i vazhdueshëm i mirëmbajtjes dhe riparimit në ndërmarrjet e sistemit energjetik. Shamgia nga ky shërbim dënohet si kundërvajtje penale me gjobë ose heqje të lirisë deri në 3 muaj.

Neni 5

Personat që tregtojnë artikuj mbi çmimet tavanë të vendosura nga Këshilli i Ministrave dënohen për kundravajtje penale me gjobë ose me heqje të lirisë deri në 1 vit.

Neni 6

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI

Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Sali Berisha